

# BANKA KOMBETARE TREGTARE

## Politika e Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës

### Qëllimi i politikës:

Kjo Politikë e Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës është përgatitur në përputhje me Ligjin “Mbi Sponsorizimet”, me Ligjin “Mbi Sipërmarrësit dhe Kompanitë Tregtare” gjithashtu edhe me legjislacione të tjera relevante Shqiptare, Dhjetë Parimet e Kompaktit Global të OKB, vlerat etike, normat ndërkombëtare dhe praktikatat më të mira në fushën e përgjegjshmërisë sociale, për të siguruar një strukturë për veprimet e Bankës drejt përgjegjshmërisë sociale në mënyrë që të krijojë një impakt pozitiv mbi mjedisin, komunitetin, klientët, punonjësit e BKT dhe të interesuarit e tjerë.

BKT i jep një vëmendje të veçantë zhvillimit dhe emancipimit të shoqërisë shqiptare. Banka ka një lidhje të fortë në sektorët e lidhur me qeverisjen, punësimin, mjedisin dhe shoqërinë.

### Parimet e Përgjithshme

Politika e Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës e BKT:

- ❖ është në përputhje të plotë me parashikimet e Ligjit “Mbi Sponsorizimet” të ndryshuar, Ligjit “Mbi Sipërmarrësit dhe Kompanitë Tregtare” të ndryshuar, dhe me legjislacionin shqiptar në tërësi;
- ❖ merr në konsideratë Dhjetë Parimet e Kompaktit Global të OKB dhe praktikatat më të mira të qeverisjes së korporatës;
- ❖ synon të arrijë një strukturë të qartë për të gjitha veprimet e Bankës në fushën e përgjegjshmërisë sociale.

### Shtyllat e Përgjegjësive Sociale

Banka lidhet në mënyrë aktive dhe të përgjegjshme në sektorët e:

#### ✓ Qeverisja

Kuptimi ynë i përgjegjshmërisë ndaj grupeve të interesit formon mendimet dhe veprimet tona. Menaxhimi i Bankës dhe stafi marrin në konsideratë në çdo proces të aktiviteteve kryesore aspektet etike, sociale dhe mjedisore. Ne synojmë krijimin e një kulture e cila mundëson lidhjet e të interesuarve si pjesë integrale të operacioneve afatshkurtra dhe afatgjata si dhe performancës në sistemin manaxhues. Në operacionet tona ditore, përveç kontributit në punësim dhe mirëqenie ekonomike, ne gjithashtu ofrojmë përfitime të tjera si transferimi i dijes, njohurive dhe vlerave të korporatës.

#### ✓ Punësimi

##### • Angazhimi social

Si një korporatë qytetare gjithashtu edhe në aktivitetet tona ditore të biznesit, politikatat tona të Burimeve Njerëzore marrin në konsideratë dhe fokusohen në aspektet e mundësive të barabarta të punësimit, respektimin e të Drejtave të Njeriut, balancimin mes jetës dhe punës, punësimin e brezave të rinj dhe përgjigjet për sfidat e ndryshimeve demografike.

- **Arsimi**

Banka angazhohet në projekte që synojnë rritjen e nivelit edukativ dhe arsimor duke rregulluar kushtet e studimit në shkolla dhe universitete, duke mundësuar bursa studimi dhe stazhe, duke bashkëpunuar në partneritet me institucionet arsimore për krijimin e programeve të ndryshme arsimore si dhe aktivitete të tjera të ngjashme.

- ✓ **Mjedisi**

Banka operon si një biznes mik me ëmjedisin, i cili, përveç veprimeve që janë në përputhje të plotë me praktikën më të mirë në mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, gjithashtu sponsorizon dhe mbështet projekte që synojnë rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e mjedisit në jetën e përditshme, si dhe projekte që mundësojnë arritje pozitive drejt përmirësimit të kushteve të mjedisit.

- ✓ **Shoqëria**

- **Ndihmat Humanitare**

BKT është shumë e ndjeshme në sigurimin e ndihmave në segmente të shoqërisë që ndikohen nga fatkeqësi natyrore si përmbytjet, zjarret, uria etj; si dhe segmente të caktuara që mund të jenë objekt i dhunimit të të drejtave të njeriut.

- **Forcimi i Institucioneve në Sektorin Publik**

BKT mbështet me dhurime, sponsorizime, trajnime dhe metoda të tjera të ngjashme forcimin e institucioneve në sektorin publik me synimin që të përmirësojnë rritjen e kapacitetit dhe nivelin e tyre operacional.

## **Zbatimi i Politikës**

Departamenti i Komunikimit të Korporatës ngarkohet me zbatimin e kësaj politike dhe përgatitjen e procedurave të nevojshme në përputhje të plotë me manualin dhe procedurat e tjera të Bankës. Kërkesat për sponsorizime, dhurime dhe projekte të tjera të lidhura me përgjegjshmërinë sociale do të menaxhohen nga Departamenti i Komunikimit të Korporatës dhe do të zbatohen pas aprovimit në nivelin e autorizuar.

## **Detyrimet dhe Ndryshimet**

Bordi i Drejtorëve është i autorizuar dhe përgjegjës për të ndjekur, monitoruar dhe përditësuar Politikën e Përgjegjshmërisë Sociale të Korporatës. Bordi i Drejtorëve është i autorizuar për të bërë ndryshime në tekstin e kësaj Politike dhe të gjitha këto ndryshime do të bëhen publike dhe do të publikohen në faqen elektronike të korporatës pas dhjetë ditësh nga data e ndryshimit.

# ANEKS

## Dhjetë Parimet e Kompaktit Global të OKB

Dhjetë Parimet Kompaktit Global në fushën e të drejtave të njeriut, punës, mjedisit dhe anti-korrupsionit kanë një konsensus universal dhe rrjedhin nga:

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
- Deklarata e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Parimet dhe të Drejtat Themelore në Punë
- Deklarata Rio mbi Mjedisin dhe Zhvillimin
- Konventa e Kombeve të Bashkuar Kundër Korrupsionit

Kompakti Global i OKB u kërkon kompanive të përfshijnë, mbështesin dhe zbatojnë brenda sferës së tyre të influencës, një set me vlerat kryesore në fushën e të drejtave të njeriut, standardet e punës, mjedisit dhe anti-korrupsionit.

### *Të drejtat e njeriut*

- **Parimi 1:** bizneset duhet të mbështesin dhe respektojnë mbrojtjen të drejtave të njeriut të shpallura ndërkombëtarisht; dhe
- **Parimi 2:** të sigurohen që ata nuk janë të përfshirë në abuzime me të drejtat e njeriut.

### *Puna*

- **Parimi 3:** Bizneset duhet të përkrahin lirinë e shoqatave dhe njohjen efektive të të drejtave kolektive;
- **Parimi 4:** eliminimin e të gjitha formave të forcës dhe të punës së detyruar;
- **Parimi 5:** heqjen efektive të punës së fëmijëve; dhe
- **Parimi 6:** eliminimin e diskriminimit në respekt të punësimit dhe pozicionit të punës.

### *Mjedisi*

- **Parimi 7:** Bizneset duhet të mbështesin një trajtim parandalues të sfidave mjedisore;
- **Parimi 8:** të ndërmarrin iniciativa për të promovuar përgjegjësi më të mira mjedisore;
- **Parimi 9:** të inkurajojnë zhvillimin dhe shpërndarjen e teknologjive mbrojtëse të mjedisit.

### *Anti-Korrupsioni*

- **Parimi 10:** bizneset duhet të luftojnë kundër korrupsionit në të gjitha format e tij duke përfshirë zvatjen dhe mitmarrjen.